



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.06.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – Kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kryetarin e Këshillit Drejtues të AKEP-it, zotin Ilir Zela, në lidhje me kërkesën e urdhëruar nga institucioni i tij për censurimin dhe mbylljen e aksesit të faqes *online* me përmbajtje satirike www.kryeministri.com.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Besnik Baraj (zëvendësues), Genc Pollo (zëvendësues) dhe deputetë të tjerë të grupit parlamentar të PD.

Mungojnë:

Musa Ulqini dhe Fatmir Velaj.

Të ftuar:

Alban Karapici – Nënkyetar i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëmëngjesi!

Hapim mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Në rendin e ditës së sotme është një seancë dëgjimore, e kërkuar nga deputetët e opozitës, me kryetarin e Këshillit Drejtues të AKEP-it, zotin Ilir Zela, për kërkesën e urdhëruar nga institucioni i tij, për censurimin dhe mbylljen e aksesit të faqes *online* me përmbajtje satirike, www.kryeminsitri.com.

Në shkresën zyrtare që ne kemi dërguar, bazuar edhe në dy nenet e Rregullores, neni 32 dhe neni 102, pika 2, është kërkuar që të paraqitet drejtuesi i këtij institucioni, zoti Zela. Edhe në komunikimet e djeshme me *e-mail*, përsëri kam insistuar të jetë drejtuesi i AKEP-it, që të vijë dhe të japë informacione për të gjitha pyetjet dhe shqetësimet në lidhje me censurën që po urdhërohet nga Kryeministri Rama, për mbylljen brenda disa orëve të aksesit të portalit www.kryeministri.com. Pavarësisht insistimit dhe referimit të dy neneve të Rregullores, të nenit 32 dhe nenit 102, zoti Zela ka refuzuar të paraqitet, gjë që unë e quaj krejt të pavend.

Unë e di që urdhrat për të mos u paraqitur dhe për të dështuar mbledhjet e këtij Komisioni merren nga lart, por mendoj se shkelja e ligjit dhe e Kushtetutës, e cila përcakton se drejtuesit e institucioneve, në bazë të Rregullores, duhet të paraqiten sa herë të kërkohet nga deputetët, është një gjendje alarmante. Shkelen ligjet, shkelet Kushtetuta, shkelet Rregullorja, duke krijuar një situatë të paprecedent.

Përderisa zoti Zela ka refuzuar të paraqitet, unë do të doja të merrja edhe mendimin e firmëtarëve të kërkesës për paraqitjen e zotit Zela, nëse ne do ta vazhdojmë këtë mbledhje apo do ta shtyjmë për ditën e hënë, përderisa të hënë ne kemi bërë edhe një kërkesë për paraqitjen e drejtuesit të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).

Sipas zotit Zela, në komunikimin që na ka dhënë dje me *e-mail*, jo në formë zyrtare, ka qenë pikërisht drejtuesi i kësaj agjencie ai që ka kërkuar mbylljen e aksesit të këtij portali satirik.

Kush e do fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arben Karapici – Jo, për të justifikuar pse mungon zoti Zela...

Albana Vokshi – Arsytet duhet t’i kishit dhënë dje, jo sot. Kemi komunikuar gjithë ditën dje me *e-mail*, apo jo? Kam kërkuar shkresat zyrtare, keni refuzuar t’i çoni.

Arben Karapici – Nuk është refuzuar...

Albana Vokshi – Keni refuzuar t’i dërgonit shkresat zyrtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do t’jua jap fjalën më pas.

Të flasin deputetët që janë firmëtarët e kërkesës.

Luan Baçi – Zonja kryetare e Komisionit, mosparaqitja e personit përgjegjës, të cilin kemi kërkuar, është në vazhden e kthimit të përgjigjeve që kemi marrë, për pyetjet drejtuar këtij Autoriteti.

Po të vëmë re, qysh në fillim, përgjigjet e pyetjeve i kanë filluar duke na dhënë leksione, duke na shpjeguar se ata nuk mbyllin faqe *online*, por mbyllin aksesin e faqes *online*, që po të ishin treguar pak më të kujdesshëm, do ta kishin parë që në fillim të shkresës së cituar nga ana jonë, ku përshkruhet shumë saktë që është për mbyllje aksesit. Ju i jeni referuar vetëm thjesht pyetjes për mbyllje portali. E solla këtë shembull, për të parë mungesën e përgjegjësisë, të papërgjegjshmërisë, do ta quaja.

Për të gjitha pyetjet që ne kemi bërë, përgjigjet kanë qenë: “Ne nuk jemi autoriteti i duhur. Ne nuk jemi organi kompetent. Ne jemi vetëm thjesht zbatues vendimesh”. Pra, këta qenkan thjesht si një lloj përmbarimi, që zbatojnë vendimet e ardhura nga organet e tjera kompetente, ku bëjnë kërkesa të ndryshme për mbyllje aksesit në portale.

Duke parë se përgjigjet e këtij Autoriteti kanë qenë të thata, madje unë do të thosha se kanë qenë edhe ofenduese, duke marrë parasysh që zoti Zela nuk është paraqitur, duke marrë parasysh edhe çështjen e tretë më të rëndësishme, që këtu del se nuk do të arrijmë asnjë gjë me thirrjen e zotërinjve, për arsye se këta nuk u japin dot përgjigje të gjitha pyetjeve që ne kemi adresuar me shkrim, ne mund të mbledhemi një ditë tjetër për të thirrur të dy autoritetet, edhe Autoritetin Kombëtar të Çertifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike, edhe Autoritetin në fjalë. Me të dyja këto autoritete, ne mund të bëjmë një seancë dëgjimore të saktë, të rregullt, për të dalë në konkluzionet e duhura.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Shezaiu, pastaj Luçi.

Shezai Rrokaj – Ne i kemi drejtuar disa pyetje AKEP-it dhe ka një përgjigje për to. Referuar përgjigjes që kemi marrë, analizës që bëhet aty, si dhe bazës ligjore, rezulton se AKEP-i nuk ka kompetencë për të mbyllur faqe. Është thjesht, si të thuash, një drejtori, e cila ekzekuton një vendimmarrje, që e merr dikush tjetër, në rastin konkret, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin dhe Sigurinë Kibernetike. Duke marrë këto përgjigje, besoj se detyra e këtij Komisioni për të kërkuar shpjegime, është të marrë bazën ligjore dhe t'i referohet bazës ligjore të këtij Autoriteti, që ka diktuar mbylljen. AKEP-i e ka ekzekutuar, sepse është ai që jep licencat për portale të kësaj natyre, por nuk është ai që merr vendimet, nëse jam i qartë.

Unë nuk them se në këtë rast fokusi i problemit është se kush ka dhënë urdhër për mbylljen e portalit dhe pse e ka dhënë këtë. Në këtë rast, unë nuk besoj se është AKEP-i, institucioni që e ka vendosur, por është një institucion sipër AKEP-it, që quhet Autoriteti Kombëtar për Certifikimin dhe Sigurinë Kibernetike. Të shikojmë se në ç'varësi është ky institucion, se cila është kompetenca e tij ligjore e kështu me radhë.

Pa e zgjatur, mendoj se ky Komision nuk do ta kryente dot sot detyrën e plotë të tij, pasi ajo që del në pah, edhe nga shpjegimet, edhe nga baza ligjore, edhe nga ligji për AKEP-in, me sa kam mundur ta shikoj, është se dikush tjetër ka urdhëruar mbylljen e portalit. Kështu që të merremi me instancën shkresore, që ka lëshuar shkresën për mbylljen e portalit. Besoj se dita e hënë duhet të fillojë pikërisht aty ku është iniciuar shkresa për mbylljen provizore të këtij portali.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Që jo rastësisht është te Kryeministria.

Unë nuk jam e qartë nga shkresa që na ka dërguar AKEP-i, profesor. Nuk jam e qartë se si funksionon, nuk jam e qartë se kush e ka dhënë urdhrin. Pse është dhënë urdhri? Sepse duhet parë përmbajtja, apo jo? Kush e përcakton nëse përmbajtja është e paligjshme apo është e dëmshme, apo që ka një rrezik shumë të madh të sigurisë kibernetike? Pra, për të gjitha këto, unë mendoj se duhej të vinte drejtuesi i AKEP-it për të dhënë sqarime. Nëse e ka hedhur më pas topin te Kryeministri, sepse agjencia që ka përmendur është direkt në varësi të Kryeministrit, është tjetër gjë.

Të hënën do t'i thërrasim të dy, por unë e quaj të paprecedent dhe të pafalshëm refuzimin e zotit Zela për të marrë pjesë sot në këtë komision. Nuk mund të refuzohet një komision parlamentar në mënyrë kaq flagrante. Kjo gjë po bëhet në mënyrë sistematike. Në çdo javë, dy herë në javë, kemi refuzim ose të kabinetit qeveritar, ose të drejtuesve të institucioneve, ose të

deputetëve, sepse marrin urdhra direkt. Kështu që ne nuk mund të vazhdojmë ta tolerojmë këtë gjendje.

Po, Luçiano.

Luçiano Boçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, çështja, për mendimin tim dhe dijeninë time, nuk është kaq e thjeshtë. Debati nuk duhet të përqendrohet te fakti se sot po mbyllet një portal nga AKEP-i, por se sot është ndërmarrë një sulm ndaj medias *online*, të cilin Kryeministria e ka investuar dhe e ka ëndërruar prej vitesh, që në momentin kur tentoi të sillte në Komisionin tonë ligjin “Për tregtinë elektronike”, që i hapte rrugë ndërhyrjes për mbylljen e portaleve me përmbajtje të paligjshme. Për shkak se ndryshimet e atij projektligji u kontestuan fort nga përfaqësuesit e medias *online*, si dhe nga përfaqësuesit e opozitës, pati një tërheqje nga ana e qeverisë, por pa pushuar asnjëherë luftën dhe gjetjen e modaliteteve për të goditur atë që ka qenë dhe mbetet problemi kryesor i Kryeministrit sot: portalet *online*. Madje, ai e ka shprehur edhe vetë se duhen mbyllur. Ka mbajtur edhe qëndrime përgjatë legjislaturës së kaluar. Kemi pasur shumë debate me ministrinë e linjës, që sot nuk ekziston, me zonjën Harito. Ajo që unë kam konstatuar, për fat të keq, është ndërmarrja e një, le të themi, procesioni ligjor, i cili i mundëson sot Kryeministrit dhe kasnecëve të tij, të mbyllin jo vetëm faqen www.kryeministri.com, por çdo faqe të medieve *online*. Është thjeshtëzuar aq shumë procedura, saqë është rrëzuar një ligj i tërë, janë rrëzuar propozimet e ndryshme ligjore dhe kemi përfunduar në një procedurë të përshpejtuar. Është skandal! Mbyllja e faqes www.kryeministri.com, nuk është rastësi, por është një projekt pilot, është testim për median *online*, se si do të jetë reagimi i opozitës dhe i medias. Të jeni të bindur se pas kësaj do të vijë edhe mbyllje të tjera. Është e parapërgatitur nga ana ligjore. Unë e di shumë mirë se përfaqësuesi i AKEP-it do t’u referohet rregulloreve, por ama, rregulloret kanë një datë. Rregullorja, të cilës i referohet AKEP-i, është miratuar në 2017-n dhe rregullorja kryesore, që ju jep juve të drejtën, është miratuar në tetor të vitit 2017. Para kësaj, para se ta miratonit ju rregulloren, që ju jep të drejtën për të ndërprerë aksesin, ka dalë vendimi i Kryeministrit për krijimin e agjencisë dhe agjencia ka zëvendësuar ALCIRT-in, për të cilin kemi pasur një debat në lidhje me financimin e mirëmbajtjes së një faqeje unike *online*, që do t’i lejonte Kryeministrit mbylljen e faqeve të tjera *online*. Faqet e mbyllura kanë qenë thjesht faqe bixhozi dhe ne e kemi anatemuar një gjë të tillë, kemi bërë edhe debat.

Vendimi për organizimin e kësaj agjencie, në mënyrë absurde, merret në një pikë të tij dhe vendoset një paragraf, që, në fakt, i ka shpëtuar edhe medieve *online*, por na ka shpëtuar edhe neve

si opozitë, sepse vendimi ka qenë i shkurtit, një javë pasi ne jemi futur në çadër. Nuk është rastësi që edhe ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale për ekstradimin, ndodhën kur ne ishim në çadër, si dhe që ndryshimet në organizimin e autoriteteve ndodhën kur ne ishim në çadër, kur vëmendja e gjithë medias ishte tek opozita dhe është futur një paragraf, që nuk ka lidhje fare me funksionimin e këtij autoriteti. Paragrafi thotë në mënyrë taksative: “Ky autoritet ngre, administron dhe mirëmban sistemin unik *online* për publikimin e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme, si më poshtë:

Faqet me përmbajtje të paligjshme konstatohen nga autoritet publike”.

Është skandal! Pra, edhe një herë, dua vëmendjen e medieve. Është: “konstatohen nga autoritetet publike”, që do të thotë se çdo ministri, çdo drejtori, çdo kryeministri, është autoritet publik dhe në qoftë se konstaton se faqja është e paligjshme, e dërgon për mbyllje. Jemi në kufijtë më maksimalë të censurës, domethënë, diktatura është për t’u përqafuar në këtë rast. Unë nuk e di pse nuk është vëmendja e AKEP-it (sepse dhe e atij duhej të ishte, por do ta diskutojmë me vonë) dhe dërgohen për mbyllje zyrtarisht pranë këtij autoriteti, jo pranë jush. Ju nuk keni tagër. Tagrin për ta mbyllur e ka autoriteti, i cili u mundëson atyre të drejtat e aksesit; ia jep ai të drejtat e aksesit, jo ju. Ju keni luajtur rolin e ushtarit në këtë rast, për publikimin e tyre, me qëllim mbylljen e këtyre faqeve. Nuk jeni ju që i mbyllni dhe nuk e keni në tagrin tuaj, pavarësisht që është hartuar rregullorja që ju jep të drejtë. Nuk është në atë kuptim ajo, e keni keqinterpretuar rregulloren. Në germën “b” thuhet: “Autoriteti nxjerr udhëzimet për funksionimin e sistemit, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e autoriteteve publike”. Në faqen e internetit ky autoritet nuk ka nxjerrë asnjë rregullore dhe asnjë udhëzim tjetër se si do të funksionojë sistemi dhe nuk përcakton as të drejtat, as detyrimet. Këto gjëra duhet t’i kishit marrë në konsideratë, jeni në marrëdhënie ndërinstitucionale, por keni tejkaluar autoritetin tuaj, sepse ky autoritet i përket kësaj Agjencie. Këtë e keni bërë në shkurt, më pas e keni hartuar në korrik, pikërisht këtë pjesë të rregullores që ju i referoheni, që është rregullorja e zbatimit të regjimit të autorizimit të përgjithshëm. Në rregulloren e autorizimit të përgjithshëm jo rastësisht keni shtuar pikërisht këto kompetenca, e keni kopsitur nga ana ligjore. Sot mediat *online* mund të mbyllen me një të lëvizur të gishtit të vogël të kryeministrit.

E lexova bazën ligjore, e di justifikimin tuaj, edhe sikur të ishte zoti Zela, e di se çfarë do të sillte këtu. Janë justifikime të kota nga ana ligjore, duhet diskutuar se cila është përmbajtja e paligjshme, sepse ju nuk keni autoritet që nuk u referoheni termave ligjorë. Si e mbyllni ju një faqe

pa ditur se cila është përmbajtje e paligjshme? Përmbajtja e paligjshme përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale. Po jua lexoj nenin 74/a, ku thuhet: “Përmbajtje e paligjshme është shpërndarja e materialeve për gjenocid, kanosja për motive racizmi dhe ksenofobie”. Në nenin 119/a trajtohet shpërndarja e materialeve raciste dhe ksenofobike, në nenin 119/b fyerja me motive racizmi dhe ksenofobie, po ashtu mund të jenë relevante nenet 143/b, mashtrimi kompjuterik, falsifikimi kompjuterik, hyrja e pa autorizuar kompjuterike, përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike, ndërhyrja në të dhënat kompjuterike, ndërhyrja në sistemet kompjuterike, këto janë përmbajtjeje të paligjshme. Mbi këto nuk ka përmbajtje të paligjshme, pavarësisht se në hapësirë ka ekzistuar një rregullore e administrimit të faqes unike *online*, për të cilën kemi pasur një debat shumë të thellë, ku edhe aty përcaktohet qartë se cilat janë faqet e paligjshme që i përputhen Kodit të Procedurës Penale. Ju nuk mund të merrni një veprim, duke mos parë Kodin e Procedurës Penale dhe duke mos parë nga ana ligjore cila është përmbajtje e paligjshme, sepse, siç e thashë, çdo autoritet publik mund të mos i pëlqejë çdo lloj publikimi në faqe dhe ai mund t’ju drejtohet juve ose autoritetit ndaj jush dhe ju ta ndërprisni. Kjo do të ndodhë me të gjitha faqet *online* që nuk i pëlqejnë, sidomos para fushatës elektorale. Pra, këtu nuk ka justifikime për të ardhur dhe për të na thënë se keni zbatuar kërkesën e autoritetit, sepse ai ka tagrin. Jo, ju evidentoni cilat janë përmbajtjet e paligjshme dhe nuk keni tagrin të mbyllni aksesin, jo një faqe.

E di justifikimin tuaj, që e keni mbyllur aksesin, sepse faqja është *.com*. Pyetja është domethënë sfiduese në këtë rast, por po të ishte *.al*, kush do ta kishte aksesin? Do ta mbyllnit faqen? Pra, nuk është përgjigje ajo. Jo më kot e keni zgjedhur *.com*, me qëllim që të kaloni pjesën e debatit për mbyllje aksesit. Në fakt, kemi mbyllur faqen dhe ky është realiteti, siç do të bëhet edhe me faqet e tjera. Pra, nëse në këtë komision përsëritet shpesh censura, ose mbyllja e gojës së medias së lirë dhe forma të tjera dhunimi të gazetarëve në formë fizike në dhunë verbale, në formë kërcënuese, këto janë reale dhe konkrete, por krimi juaj ndaj medias është kaq *perfit* me mënyrën si i keni renditur gjërat dhe si i keni ngritur këto autorite, qëllimisht për t’u marrë vetëm me median *online*, sikur krimi kibernetik është te media *online*. Kjo është e tmerrshme! Sot në Shqipëri mund të klikosh lirshëm faqe pedofilie, faqe seksi, faqe pornografie, faqe terrorizmi. Nuk e di pse AKEP-i në arsyetim thotë “mijëra kërkesa”? Jo, nuk janë mijëra kërkesa, hapeni portalin e autoritetit dhe shihni ka të bllokuara 56 adresa të NATO-s, që janë të rekomanduara nga NATO-ja dhe nuk ka asnjë iniciativë të vetën. Autoriteti duhet ta kishte shënuar te faqja e vet që e bllokoi, e ka vetë në portal. Pa e futur ai në portal, ju nuk mund të veproni dot, se mos nxirrni kot rregullore, keni

tejkualuar çdo gjë. Jeni në kundërshtim të plotë me ligjin, jeni për hetim, jeni për t'u çuar në prokurori, sepse vetë kryeministria nuk e ka nxjerrë të bllokuar faqen. Autoriteti nuk e ka të pasqyruar. Ju thashë ta hapni faqen, janë thjesht adresa IT-je, të ardhura nga NATO-ja, nuk ka asnjë adresë tjetër. Pra, sot ju pararendni me një veprim që duhej të ishte bërë nga ndonjë autoritet tjetër, pra ju nuk veproni ndaj faqeve që vërtet kanë përmbajtje, të themi, të paligjshme, siç unë i përmenda, ose që janë sulme kibernetike ndaj faqeve të ndryshme, por thjesht jeni vënë në shërbim të kryeministrit.

Në fakt, ndoshta kjo pjesa e shërbimit tim tekniko-ligjor e komplikon edhe retorikën, sepse retorika duhet e pastër dhe e thjeshtë politike. Jemi para goditjes më të madhe që i është dhënë lirisë së shtypit, lirisë së fjalës, e cila po goditet në thelbin e vet dhe sot ka kapur pjesën më të madhe të publikut me të cilën është në kontakt çdo moshë dhe lloj kategorie. Ky ka qenë projekti i kryeministrit. E nisi me ligjin për tregtinë elektronike, nuk ia doli dot; vazhdoi me Alcirtin ku i jepte të drejtë të administronte faqen unike *online* për të bllokuar të gjitha këto me përmbajtje të paligjshme, prapë nuk ia doli. Pastaj ndërtoi një arkitekturë marrëdhëniesh ligjore institucionale që është ajo që do të sjellë censurimin, sepse u mbyll portali *kryeministri.com*. Më falni, në bazë të ligjit, sikur një autoritet publik të hamendësojë t'ju kërkojë mbylljen e *Facebook*-ut, do të thoni që nuk e bëni, sepse ka kryeministri ERTV- në? Po sikur ta kërkojë, ju keni të drejtë të mbyllni aksesin? Po, keni të drejtë, sepse e keni sipas ligjit. Atëherë çfarë përgjigje do të jepni ju? Do të mbyllni rrjetet sociale, sepse jua mundëson ligji. Edhe ajo rregullorja që ju paraqisni, jua mundëson. Pra, çfarë do të bëni ju si AKEP? Ju si AKEP keni të drejtën dhe detyrën të përcaktoni me rregullore të veçantë marrëdhëniet me institucionet dhe autoritetet. Në rastin kur ata ju drejtohen ju, që të verifikoni të vërtetën e përmbajtjeve të paligjshme, ju do të mbyllni sytë? Pra, shqetësimi juaj mbetet i tillë, sepse këtu asgjë nuk është e rastit, gjërat janë të përlllogaritura. Thashë është një krim përfit ky ndaj medias *online*, prandaj unë do të kërkoja involvimin e të gjitha energjive të medias *online* dhe *joonline*, e cila duhet të reagojë dhe të protestojë siç bëri atëherë për ligjin “Për tregtinë elektronike”; atë që Rama nuk e futi dot nga dera, e futi nga dritarja sot.

Debati ynë nuk do të kishte vlerë nëse do të thoshin çfarë ka bërë AKEP-i. I di justifikimet tuaja, në lidhje me rregulloren, pikën 9, që i referohet ligjit “Për komunikimet elektronike”, e keni kopsitur, por jo aq mirë, sepse ka shumë gjëra të tjera që do t'i diskutojmë. Por ama jemi para kësaj sate, kur sot kërkohet me forcë nga kryeministri, nga kjo qeveri, mbyllja e protaleve

online, atyre portaleve që si *kryeministri.com*, shkruajnë gjëra që nuk shkojnë përshtat me oreksin politik të qeverisjes dhe kryeministrit, sepse kritikojnë qeverinë, deklarojnë të vërtetën.

Sot jemi në alarm, sot komisioni ynë duhet të ngrihet në këmbë, sepse këtij komisioni dhe parlamentit, ia ka hedhur Kryeministria. Rregullorja që ju do ta paraqisni duhet të kalonte patjetër në Komisionin tonë të Medias. Do të thoni ju se nuk është tagër ligjor i këtij komisioni. Po, nga përmbajtja që ajo ka është tagër ligjor i këtij komisioni, sepse ka të bëjë pikërisht me median e lirë. Jo të mblidheni ju me urdhër politik dhe në korrik të vitit 2017 të hartoni një rregullore që ju jep juve të gjitha të drejtat e botës që të zbatoni një urdhër politik, që ju vjen nga zyrat e qeverisë. Nuk janë autoritet publike që konstatojnë përmbajtje të paligjshme. Jo, e përcakton Kodi dhe gjykata, sepse jemi shtet ligjor. Por, në fakt, nuk jemi shtet ligjor, ne jemi vetëm në letër shtet ligjor, sepse përmbajtjen e paligjshme e përcakton kryeministri. Ky është absurditeti më i madh në Shqipëri. Të dalë një parti politike si autoritet dhe të thotë se cila është përmbajtja e paligjshme. Këtë nuk e them thjesht për situatën e tanishme. Çdo pushtet politik mund ta shfrytëzojë këtë mbërthim ligjor për interesat e tij dhe të mbyllë çdo faqe *online*, kur nuk shkon me orekset e tij, sepse i është dhënë tagri, i është shkruar nga ky kryeministër dhe ky është turpi më i madh që ka ndodhur në Shqipëri.

Unë jam tronditur kur e kam parë mënyrën si është realizuar ky lloj krimi ndaj medias *online*. Thashë edhe një here, *kryeministri.com* është një faqe relativisht e klikueshme, relativisht e pranueshme, por kritikën më të fortë ndaj qeverisë nuk janë vetëm me ironi, por janë edhe me fakte, me dëshmi të cilat sot janë nën presionin e kësaj qeverisjeje dhe këtij kryeministri, sepse, nëse nuk do të ishin mediat *online*, nuk do të dilte as përgjimi i Xhafajt, nuk do të dilte asgjë tjetër dhe sot ne do të ishim në terr informativ. Janë mediat *online* që servirin në çdo moment, çdo element.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e kam kohën të pakufizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të dy, Milva, me veshin e djathtë mua, me veshin e majtë atë. Zgjidhe e merr.

Albana Vokshi – Kemi kërkuar zotin Ilir Zela.

Luçiano Boçi – Unë nuk e kam kohën të kufizuar. Ndodh gjithmonë ky fenomen që në parlament kemi Gramozin që e ka me minutazh dhe nuk na lë, këtu ndërhyti ju dhe është pa minutazh. Parashtrimin çdo njeri e bën sipas mënyrës së vet. Siç unë dëgjoj të tjerët, duhet të më

dëgjoni edhe ju. Këtu bëhet fjalë për të ngritur alarmimin e mediave *online*, sepse sot kanë marrë goditjen më të madhe. Ky është projekt pilot për ta testuar reagimin, sepse një autoritet publik urdhëron një institucion që e ka në varësinë e tij. Ky është turpi i botës, sepse është në varësinë e kryeministrit, i cili urdhëron AKEP-in që është institucion që varet po nga qeveria të mbyllë portalet *online*. Po ku jemi ne këtu? Kjo nuk është demokraci...

Albana Vokshi- Po, zonja Milva.

Milva Ekonomi- Faleminderit për sqarimin tekniko-ligjor të situatës që ka AKEP-i. Në fakt, unë çuditë, kur keni bërë kërkesën, pse nuk keni thirrur edhe agjencinë tjetër? Pra, kur i kishit të gjitha këto njohuri, thirrja që i keni bërë vetëm AKEP-it pa agjencinë tjetër, duket sikur është bërë enkas.

Albana Vokshi – AKEP-i u tregua më i sigurtë se ç'duhet, tregoi edhe burimin e urdhrit, kështu që ju lutem vazhdoni.

Milva Ekonomi - Kjo më bën të mendoj që e njihni sektorin shumë mirë. Tregoni që ka një rregullore dhe thoni që po fillon sulmi i medias së lirë. Në Shqipëri funksionojnë 300 portale dhe shembulli i një portali nuk është aspak domethënës në këtë diskutim që po bëjmë, por të mos harrojmë që portali *kryeministri.com* përdor dizajnin dhe logon e web-it zyrtar *kryeministria.al*. Përdor një adresë e-mail-i me domenin shqiptar Shqipëriaqëduam@kryeministria.al, përdor adresën e e-mail-it Shqipëriaqëduam@kryeministria.al me 5 publikime të klikueshme nga publiku, të cilët mund të besonin se ky mund të ishte një njoftim zyrtar.

Albana Vokshi– Milva, çfarë po lexon? Po lexon argumentimin?

Neve na është refuzuar kjo shkresë. Pse ti e ke dhe unë nuk e kam?

Milva Ekonomi - Këtë e kam zbuluar unë, siç ke bërë ti kërkimin.

Albana Vokshi – Unë kam kërkuar argumentimin, por neve na është refuzuar. Milva po e lexon.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Nuk mund të censuroni informacionin ndaj opozitës ju.

A janë të tuat ato?

Milva Ekonomi- Po, siç ke të drejtë ti të bësh kërkim, të përdorësh bazën ligjore dhe të bësh interpretim, edhe unë kam të drejtën...

Albana Vokshi – Ju lutem, mos bërtisni më këtu në komision! Uleni zërin!

Fjalën e ka zonja Ekonomi.

Ju lutem, mos bërtisni më këtu!

Milva Ekonomi- Unë kam të drejtën të përdor njohuritë e mia, të bëj grumbullime informacionesh, siç bëri zoti Boçi para meje. Unë këto i kam kërkimet e mia personale.

Në të gjithë këtë situatë kuptohet që edhe veprimtaria që ka ndërmarrë AKEP-i, edhe urdhri që është dhënë më sipër është një urdhër që del pikërisht nga burimi i keqpërdorimit të adresave mëmë. Në këtë rast unë besoj se argumenti im për mbylljen e një portali është më se i drejtë. Në Shqipëri ekzistojnë portale satirike dhe ky nuk është i vetmi. Ky është një portal satirik që përdor *web-in kryeministria.al*, prandaj ai është i rrezikshëm dhe i paligjshëm, sepse deformon informacionin për publikun dhe portalet krijohen për të informuar publikun, jo për të dezinformuar publikun. Kështu që në këtë rast do të bëjmë shumë kujdes, duke vendosur të gjitha burimet e informacionit në tërësinë e vet, jo vetëm tekniko-ligjor, por edhe kibernetik dhe të sigurisë kibernetike. Kështu që unë besoj se para se ta vazhdojmë këtë dëgjese, do të ishte mirë edhe për ne për të kuptuar si funksionojnë gjërat, të thërrisim edhe drejtorin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike dhe pastaj të vazhdojmë dëgjесën, sepse tani bëjmë vetëm shou politik. Unë besoj se është mirë të ndërpresim dëgjесën dhe të vazhdojmë të hënën me dëgjесë më të plotë.

Albana Vokshi- Të thuash që ka 300 portale dhe nuk është problem se u mbyll një, a kuptoni se me çfarë mentaliteti vini ju këtu?

Ti thua se “e heq unë këtu”, se ka 300 të tjera që më pëlqejnë mua”! Kjo që është satirë dhe kritikon kryeministrin, ministrin, mënyrën si juve...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë do të arrij...

Milva Ekonomi – ... dhe nuk kërkon pilot...

Albana Vokshi – Ju lini ato që do Kryeministri..

Milva Ekonomi – Të fillosh një gjë pilot, siç thoni ju...

Albana Vokshi – ... dhe hiqni ato që shajnë Kryeministrin, shajnë ministrin....

Milva Ekonomi – ...duhet të paktën që 30 portale të fillojnë të mbyllen, gjë që në njësi specifike është shumë e vogël...

Albana Vokshi – Do të kërkojmë sqarime deri në fund...

Milva Ekonomi – Ky portal përdor *web-in Kryeministria.al*...

Albana Vokshi – Nuk do ta lejojmë Edi Ramën të hapë dhe të mbyllë...

Milva Ekonomi – Nuk i hap dhe nuk i mbyll Edi Rama, se Edi Rama i ka lënë mediet të bëjnë çfarë të duan...

Albana Vokshi – Pse nuk mbyllet ERTV-ja? Është një televizion i paligjshëm, ka përmbajtje të paligjshme dhe të dëmshme...

Milva Ekonomi – ERTV-ja është video-lajm në *facebook*...

Albana Vokshi – Të mbyllet...

Milva Ekonomi - Shkoni pyesni Mark Zuckerberg-un pse nuk e bën?

Albana Vokshi – Të mbyllet se është e dëmshme, është politizur dhe ka frikë...

Milva Ekonomi – Ju keni frikë nga ndjekësit që ka ERTV-ja, sepse kjo është pyetja që po shtroni tani...

Albana Vokshi – Zoti Pollo e ka kërkuar fjalën.

Genc Pollo – Faleminderit, zonja kryetare dhe kolegë të Komisionit për Edukimin dhe Medien!

Unë mendoj se është në detyrimin dhe nderin e AKEP-it të përfaqësohet nga titullari, megjithëse nuk kam asnjë dyshim për profesionalizmin e zotit Karapici, si dhe në tagrin e komisionit tuaj për të insistuar që të paraqitet titullari. Gjithsesi ky është një vendim që ju takon ju, sepse nuk jam anëtar i komisionit tuaj. Sot kam ardhur në këtë komision me interesin më të madh, sepse kam qenë për 4 vjet anëtar i këtij komisioni dhe kemi debatuar jo pak për lirinë e medias gjatë legjislaturës së shkuar. Për 4 vjet kam qenë ministër i fushës përgjegjëse për komunikimet elektronike, telekomunikacionin, madje kam qenë edhe ministër propozues në një projekt të mbështetur nga USAID-i për themelimin e ALCIRT-it -t, i cili sot quhet me një emër tjetër, AKCESK, dhe që rezulton të jetë përfshirë në këtë mesele, dhe që ju me të drejtë kërkon ta thërrisni dhe ta dëgjoni.

Po ju them, nuk më ka shkuar për asnjë sekondë në mendje, kur përgatisnim aktet ligjore për themelimin e kësaj agjencie, që kjo mund të përdorej apo të keqpërdorej, siç rezulton, për mbylljen e një *website* lajmesh për arsye politike. Gjithsesi, jam dakord të mos dalim në konkluzione, të dëgjojmë, siç keni ndërmend të bëni ju, shpjegimet e plota të AKEP-it dhe të autoritetit, por ajo që duhet thënë është se përgjigjja e shkruar nga AKEP-i më duket shumë informuese. AKEP-i, e ka hequr nga vetja e vet përgjegjësinë dhe Ilir Zela, si kryetar i tij ia ka lënë fajin në derë Kryeministrit Edi Rama. Ai e thotë qartë: “Nuk e kam mbyllur me iniciativën e time, por kam qenë i urdhëruar AKCESK-u”. Ai mund të ketë të drejtë bazuar në ligj, por pyetja është:

çfarë tagri, arsyeje dhe motivi mund të ketë AKCESK-u për të mbyllur një domen satirik? Tagri i tij i vetëm sipas VKM-së së asaj kohe, kur unë isha minister, dhe sipas ligjit që u miratua para 3 vjetësh, është për të mbyllur *website*-t, serverët, të cilët përbëjnë kërcënim kibernetik për *website*-t, për rrjetet, për serverat e institucioneve shtetërore. Ky është thelbi i mandatit të kësaj agjencie, e cila varet direkt nga Kryeministri. Kështu është sot, kështu ka qenë edhe para 7 vjetësh, kur është themeluar.

Pra, për të mos u rënë gjërave përqark, nuk është bindëse ajo që dëgjova se ka ngjashmëri, ka parodizim të *website*-ve zyrtare *Kryeministria.al*; jo, ajo është *Kryeministria.com*. Mund të ishte *Kryeministria.com*, *Kryeminsitria.net* apo simbole të tjera të ngjashme, sepse gjëra të tilla ndodhin rëndom, por, në qoftë se ka vjedhje të identitetit apo të pronësisë intelektuale, këto janë çështje komerciale, rruga për ta zgjidhur këtë problem është përmes gjykatës dhe jo përmes Agjencisë së Sigurisë Kibernetike që trajton vetëm rastet kur nga këto *website* lëshohen bote, lëshohen viruse, të cilat sulmojnë *website*-t qeveritare, rrjetet dhe serverat që i mbështesin ato. Ky është mandati. Në qoftë se nuk jeni dakord me mua, rilexojmë ligjin, i cili është miratuar legjislaturën e shkuar.

Ajo që nuk u tha këtu dhe mendoj se është me interes për publikun, është se ky *website* është bllokuar nga agjencia e Kryeministrit, jo kur shfaqte ngjashmëritë me *website*-n zyrtar të Kryeministrit, por në momentin që bëri parodinë për ministrin e Brendshëm, duke thënë në stilin e humorit dhe të satirës me të cilën jemi më të familjarizuar: “Qeveria ka shpallur postin vakant për ministër të Brendshëm. Kriteret: të mos ketë qenë hetues...”

Më falni, satira kështu e do “të ketë qenë hetues i komunizmit, të ketë vëllain të dënuar në Itali për drogë për 7 vjet e sipër, të ketë ndryshuar apo bllokuar ligje për ta favorizuar vëllain e kështu me radhë...” A ka këtu satirë politike? Besoj se ka. A ia kanë futur kot? Kjo besoj se është çështje debati, se fakte kanë dalë. Po të ishte qeveria më e mirë e mundshme, prapë satira do të ishte e pranueshme, por ky është ministri që ne kemi dhe paraardhësi i tij ishte i akuzuar për çështje droge dhe ishte në arrest shtëpie, derisa e lanë në gjendje të lirë, siç e ka thënë njëri në Tiranë, me ryshfete e trysni. Kjo nuk është më satirë, por denoncimi i një situatë politike, për të cilën media ka plotësisht të drejtë, për të cilën ne kemi të drejtë dhe detyrë ta bëjmë, sepse më kujtohet që mbledhja e komisionit ishte dominuar nga pyetja: a ka Partia Socialiste në pushtet njerëz për t’i vënë në qeverisje, që nuk kanë familjarë të lidhur me drogën dhe me ndëshkime gjyqësore që të fitojnë besimin e publikut? Kjo pyetje nuk mori përgjigje, sepse në rrethana të qarta nuk mund të marrë përgjigje, por kjo nuk është çështja që po diskutojmë sot. Çështja që diskutohet sot ka të

bëjë me një tejkalim që është bërë, dhe unë dyshoj, nuk po e them si konkluzion, por si dyshim të fortë, sepse provat të gjitha aty të çojnë, apostafat nga agjencia e Kryeministrit dhe nuk mund ta mendoj se është bërë me iniciativën e tyre pa porosi nga shefi, por kjo duhet verifikuar.

Unë ju inkurajoj të merrni letërkëmbimin midis AKEP-it dhe AKCESK-ut dhe të kërkonit të gjitha procedurat e AKCESK...

Albana Vokshi – E kemi kërkuar, por kanë refuzuar ta dorëzojnë.

Genc Pollo – Kjo është një çështje që nuk mund të mbyllet këtu, me arrogancë dhe me idenë që Europa dhe bota për aq kohë sa nuk e çajnë kokën nga opinionimi publik i brendshëm, nuk kanë kohë të merren me këta, se janë të zënë me halle të tjera. Por unë nuk besoj të jetë kështu. Ju mos u merrni se çfarë bëjnë të tjerët me ne, por shihni se çfarë do të bëjnë të tjerët për veten dhe besoj se është detyra e Kuvendit, në radhë të parë e komisionit tuaj, zonja kryetare, që kësaj çështjeje, pasi të sqarohen faktet dhe, pas tyre, me nxjerrjen e konkluzioneve dhe veprimeve të mëtejshme, t'i shkohet deri në fund.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Zoti Mima, e ka kërkuar fjalën.

Florion Mima – Faleminderit, zonja kryetare!

Në respekt të axhendës së punës së komisionit tuaj, por edhe të pozicionit tim si anëtar i një komisioni tjetër, më lejoni të bëj dy-tre komente të shkurtra për temën që po diskutohet.

Ju sot po diskutoni heqjen e aksesit në një portal. Unë gjykoj se kjo është mjaft e rëndësishme, njësoj siç është heqja e aksesit të 30 mijë familjeve që janë përzënë nga skema e ndihmës ekonomike dhe nuk kanë akses për një kothere bukë; nuk kanë akses për të njomur buzën me ujë. Kjo është po aq e rëndësishme sa heqja e aksesit të 380 mijë vetave, të cilëve nuk u lejohej të shijojnë atdheun e tyre, prindërit dhe familjet e tyre në këtë tokë, por përzihen me shkelma; po aq sa ç'është e rëndësishme mbyllja e 5 mijë bizneseve vetëm në 3 muaj, në të cilat minimalisht punësohen 10 mijë njerëz, të cilët sot nuk kanë akses të marrin rrogën e tyre.

Po ashtu, gjykoj se është e rëndësishme po aq sa mungesa e hapjes së negociatave. Është e qartë për të gjithë tashmë që negociatat nuk do të hapen se nuk do Partia Socialiste, Partia Demokratike. Jo, kam bindjen se edhe mes jush, kolegë të maxhorancës, ka njerëz që duhet ta mbajnë kokën lartë. Një pjesë fare e vogël, specifikisht pjesa e lidhur me Rilindjen, mund të kenë arsye ta mbajnë kokën poshtë, le ta mbajnë për këtë zarar të madh që i bënë vendit. Cilat janë

klanet? Shihni rotacionet e klaneve në Ministrinë e Brendshme, klani i mariuhanës iku, erdhi, kreu misionin e vet, e kanabizoi vendin me një xhiro vjetore, siç është shprehur EUROPOL-i, 9 miliardë euro, 4 miliardë është buxheti i shtetit në Shqipëri, pjesa më e madhe e ardhur nga Shqipëria. Në ikje e sipër është klani i kokainës, 2 miliardë e gjysmë euro, thonë Kombet e Bashkuara. Por krimi më i madh nuk është ky, krimi më i madh është se 2,5% e popullsisë është e varur nga kokaina. Janë 80 mijë të rinj shqiptarë që nuk e dinë nëse nesër do ta kenë jetën të sigurt apo jo! Kanë rënë në kthetrat e drogës dhe vështirë të dalin pa një përpjekje serioze të të gjithëve ne.

Ka edhe një klan tjetër që po bëhet gati, klani i heroinës, i cili, siç do të vijë shumë shpejt, do të ikë. Ndaj nuk hapen negociatat. Lexoni raportet e OSBE-së; klithmat e tyre janë ulëritëse për një vend që do të anëtarësohet në BE! Nuk ka Gjykatë Kushtetuese, nuk ka Gjykatë të Lartë. Gjykoj që për të gjitha këto duhet të diskutojmë. Po jua përsëris edhe një herë tjetër, brenda Partisë Socialiste ka njerëz të mirë, të ndershëm, me integritet, që e duan këtë vend, duan edhe integritimin.

Ju duhet të çliroheni urgjentisht nga Rilindja!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar zoti Bumçi, por po jua jap juve!

Mos e rrëmbeni mikrofonin!

Ismet Beqiraj - Ne jemi anëtarë të komisionit. Kemi një rend dite për të diskutuar. Do të bëjmë 4 pyetje. Bashkohem edhe me mendimin e kolegëve propozues për të thirrur kryetarin e AKEP-it, edhe të institucionit tjetër, që është Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Në qoftë se do të fillojmë me procedurën që ka Rregullorja, me pyetjet, dhe pastaj të përgjigjen përfaqësuesit e institucionit, në rregull, le të vazhdojmë! Ama, në qoftë se do të vazhdojmë me politikën dhe do të ngatërrojmë tribunat politike të partive me këtë komision, nuk i shërbejmë as çështjes dhe as integritit.

Sa për drogën dhe të gjitha krimet e tjera që kanë ndodhur këto 27 vjet në Shqipëri, e kam thënë dhe e them: krimi dhe droga nuk kanë lindur për 4 vjet! Shqipëria nuk u kanabizua këto 4 vjet, por ka 27-28 vjet. Zotërinjtë të mos bëjnë apologjinë, virgjërinë këtu! E dimë ç'është Shqipëria, e dinë të gjithë shqiptarët!

Kjo sallë është mbipopulluar edhe me kolegë të tjerë dhe do ta vazhdoni deri në fund, derisa Europa të japë mendimin përfundimtar për Shqipërinë. Por unë kam shumë shpresë, sepse mendoj

më shumë për shqiptarët sesa për ato ekipe politike që vijnë e ikin nga pushteti. Mos e harroni këtë!

E kam thënë edhe dje, edhe sot, nuk i bëjmë mirë çështjes duke hedhur vetëm baltë, duke nxirë veten tonë!

Miq, vëllezër, kolegë, le ta shikojmë gotën gjysmë plot, jo gjithnjë bosh, duke goditur vetveten!

Jam plotësisht dakord që çdo gjë të bëhet institucionale dhe të mos mendojmë gjithmonë se na i kanë hedhur për këtë legjislacion, edhe për Rregulloren. Duket sikur në Shqipëri ka një terr informativ. Nuk është e vërtetë! Ishin kohëra të tjera kur digjeshin redaksitë, kur goditeshin me plumb gazetarët dhe rrëmbeheshin! Tani kudo, nga të gjitha anët, na rrethojnë portalet, duke na thënë një mijë e një gjëra, nga mëngjesi në darkë, mijëra tonelata bojë të zezë, mijëra tonelata balte janë hedhur për çdo përfaqësues politik dhe drejtues.

Ndaj, ju lutem, kolegë të nderuar të opozitës, në qoftë se keni ardhur vetëm për *show-n* e radhës politik, kam respekt për personalitete, që në fushat tuaja jeni të tillë, jemi në Komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, rrezatoni energji pozitive, rrezatoni energji të shëndetshme për këtë popull, për ta afruar rininë dhe jo për ta larguar atë.

Do të propozoja që të vijë drejtuesi i AKEP-it dhe përfaqësuesit e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike. Ta ndalim debatin dhe të mos vazhdojmë të bëjmë retorikë shterpe dhe të kotë!

Albana Vokshi – Faleminderit!

(Diskutim pa mikrofon.)

Pyetja është pse u mbyll portali. Kaq! Kësaj pyetjeje...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju dëgjova dhe nuk ndërhya!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëse nuk të pëlqen, zotëri, mund të ikësh, siç ke ikur dhe mund të bojkotosh siç ke bojkotuar në mënyrë sistematike!

Ismet Beqiraj - Kujt do t'ia bësh atë pyetje, se për zotërinjtë ti nuk pranon!

Albana Vokshi –Pyetjen do t'ia bëj kujt të dua dhe mbylle mikrofonin, sepse ka kolegë të tjerë që duan të marrin fjalën. Respektojini ata!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për 380 të rinjtë, fajin e keni ti, Rama, qeveria jote, droga, krimi dhe ministrat e lidhur me to.

Ndaj, ti i pari duhet të distancohesh nga ministrat e Brendshëm, të lidhur me krimin!

Tani, mbylle atë mikrofon, sepse ka kolegë të tjerë që presin të diskutojnë.

Retorika juaj është për të ardhur keq!

Distancohuni!

Keni vetëm 23 ditë kohë. Mbledhjet e komisionit bëhen për të na afruar ne dhe Shqipërinë me Europën. 23 ditë për të kujtuar që demokracia në Shqipëri është në rrezik; 23 ditë për të reaguar, për të mos mbyllur portale që janë kritikë ndaj ministrit të Brendshëm dhe Kryeministrit; vetëm 23 ditë që të mos dhunoni gazetarët, të mos shantazhoni pronarët e mediave; 23 ditë të filloni të luftoni krimin e organizuar; 23 ditë që të shkarkoni Ministrin e Brendshëm dhe të tregoni që e keni seriozisht plotësimin e kriterëve. Keni kohë 23 ditë, sepse po mbani peng një Shqipëri të tërë, po mbani peng rininë; 23 ditë nga marrja e vendimit!

Ne jemi këtu për ta afruar më shumë Shqipërinë me Europën! Një komision parlamentar, i cili i kërkon llogari qeverisë, sepse po censuron mediet, na çon më afër Europës.

Tani mbylle atë mikrofon dhe mjaft bëre zhurmuesin!

Fjala për zotin Bumçi.

Aldo Bumçi – Faleminderit!

Do të doja të thosha dy gjëra: është mbyllur një portal që ishte kritik ndaj qeverisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I paligjshëm apo jo, e vendos gjykata!

Fjala e lirë, shprehja e lirë dhe media e lirë kanë të bëjnë me të drejtën themelore kushtetuese. Ku do të shkojë ky portal, medie të tjera apo qytetarët kur u cenohen të drejtat themelore?

Sot, institucioni garant i të drejtave tona themelore, Gjykata Kushtetuese, nuk ekziston. Nuk ekziston, sepse e mbylli Edi Rama. Nuk mund të mbyllet një institucion, sepse dy anëtarë nuk justifikojnë dot të ardhurat e tyre. Institucioni ka më shumë vlerë sesa ata dy anëtarë, sepse me këtë logjikë, në një vend nuk duhet të ekzistojë as dogana, as policia dhe asnjë institucion tjetër.

Gjykata Kushtetuese është ajo që mbron të drejtat dhe dëshiroj t'ju kujtoj shembuj konkretë kur Kryeministri mori vendim: kaloi ligjin për procedurat tatimore, që nëse në një biznes gjendej një punonjës i pasiguruar, apo një kupon të paprerë, gjoba që do t'i vendosej, do ta çonte në

falimentim të gjithë biznesin. Pra, për një kupon të paprerë, gjoba nuk ishte në proporcion me shkeljen. Gjykata Kushtetuese vendosi që kjo është antikushtetuese, duke mbrojtur nga falimentimi apo presioni tatimor dhjetëra, mijëra biznese në këtë vend. Kush i mbrojti këto biznese? I mbrojti Gjykata Kushtetuese.

Kryeministri kaloi një vendim që kërkonte identifikimin e çdo numri celulari, IMEI-n e çdo numri, besoj se e mbani mend, shkelje e rëndë e privatësisë personale. Mesazhe, fotografi, komunikime private mes njerëzve, të afërmeve, të dashurve të tyre, identifikoi çdo numër, çdo mesazh dhe çdo fotografi. Këtë e kërkoi ministri i Brendshëm. Gjykata Kushtetuese mbrojti të drejtat themelore të qytetarëve dhe privatësinë.

Kryeministri mori vendim që shtëpitë me leje, jo vetëm ato pa leje, mund të prisheshin me VKM, kur janë kundër planeve rregulluese. Ju kujtoj që Tirana u ndërtua pa plan gjatë 11 vjetëve, u dhanë leje. Shtëpitë mund të prisheshin pa dëmshpërblim. Gjykata Kushtetuese e rrëzoi këtë vendim dhe mbrojti shtëpitë e qytetarëve shqiptarë.

Pra, kjo gjykatë që ka mbrojtur të drejtat themelore të biznesit, të pronës, privatësinë, jetën e çdo qytetari, sot nuk ekziston dhe nuk mbron dot më fjalën e lirë. Si Gjykata Kushtetuese edhe Gjykata e Lartë, po shkon drejt rrënimit, ajo është e rrënuar si në numër gjyqtarësh, ashtu dhe në numër çështjesh. Janë 27 mijë çështje të patrajtuara, numri rritet dhe mund të ketë shkuar në 30 mijë. Nuk ka më drejtësi në Gjykatën e Lartë se nuk funksionon. Prokurorja e Përgjithshme është emëruar me 69 vota kur Kushtetuta thotë me 84 vota, Prokurorja e Krimeve të Rënda është emëruar pa bazë ligjore, pra, nuk ka asnjë bazë ligjore, nuk ka ligj që të justifikojë emërimin e Prokurores së Krimeve të Rënda. Gjykata Kushtetuese nuk funksionon, Gjykata e Lartë është gjithashtu e pezulluar, kurse prokurorja është e emëruar politikisht.

Çfarë është mbyllja e një portali kur ka kapur drejtësinë dhe është zot i këtij vendi?! Unë besoj ka një lajm të mirë të mbyllja e një portali dhe një mesazh të mirë për të gjithë shqiptarët. Cili portal është mbyllur? Kryeministri.al. Unë mendoj se ky portal, që është mbyllur, duhet t'u thotë shqiptarëve që ne t'i mbylлим kryeministrinë Edi Ramës. Çfarë vendimesh ka marrë aty Edi Rama? Në atë zyrë Edi Rama ka marrë vendime që i ka varfëruar shqiptarët. 45 mijë familje janë hequr nga ndihma ekonomike, 20 mijë para dy muajsh, dhe para dy vjetësh hoqi 25 mijë të tjera. Në atë zyrë Edi Rama ka marrë vendim që shqiptarët të paguajnë naftën më të shtrenjtë në botë, gjë që e bën të vështirë bujqësinë, biznesin, transportin e qytetarëve. Bëjnë jetën e shtrenjtë. Në atë zyrë Edi Rama ka marrë vendim që të kanabizohet Shqipëria me Sajmir Tahirin dhe me

Fatmir Xhafajn sot. Në atë zyrë ai merr vendim të mbrojë Fatmir Xhafajn. Në atë zyrë Edi Rama ka marrë vendime që kanë varfëruar dhe kriminalizuar Shqipërinë, prandaj shqiptarët t’ia mbyllin atë zyrë Edi Ramës, se nuk është i denjë për atë zyrë, pasi e përdori për të kriminalizuar dhe varfëruar këtë vend. Pra, mesazhi që na ka çuar Edi Rama duke mbyllur atë portal, ta kthejmë në realitet, t’i mbyllim virtualisht dhe fizikisht zyrën atij njeriu, se është i padenjë për atë zyrë.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Fjalën e ka Orjola, pastaj Zoti Gurakuqi dhe zonja Duka.

Orjola Pampuri – Këtu u fol për gotën bosh dhe gotën plot, u fol për konstruktivitet dhe destruktivitet. Jashtë po bëhet një protestë e minatorëve, që besoj se të gjithë e dëgjojmë, të cilët kërkojnë miratimin e statusit të minatorit dhe nuk është miratuar. Kemi zhvilluar seanca dëgjimore me ta, e kanë kërkuar dhe nuk ua kemi miratuar. Besoj se aty do të jenë edhe 50 mijë familje, që janë përjashtuar nga ndihma ekonomike, po t’u shtojmë këtyre edhe 400 mijë të tjerë që janë larguar nga Shqipëria, madje t’iu shtojmë edhe persona që janë larguar nga puna për bindje të ndryshme ose për bindje kundër kësaj qeverie, imagjinoni sa shumë do të ishin sot aty jashtë, ndërkohë që ne jemi këtu dhe dëgjojmë thirrmat e minatorëve.

Tani, unë jam dakord, se për shkak të profesionit mendoj që gotën duhet ta shohim gjithnjë plot, por si mund ta shohim gotën plot kur jemi të dehur nga krimi dhe droga? Si mund ta shohim gotën plot kur kemi dy ministra, njeri i implikuar me kushërinj kurse tjetri me vëlla? A mendon ndonjëri nga ju, e kam thënë edhe në komisione të tjera, se kush ka vëllain apo dikë tjetër të implikuar, do të ishte i denjë të mbante atë karrige? A mendon ndonjëri nga ju që përfaqëson ndonjë qytetar, nëse është i inkriminuar apo i implikuar në trafik droge? Secili prej nesh këtu përfaqëson qytetarët dhe u ofron një model atyre jashtë. Çfarë modeli mund të ofrojë një ministër, i cili rri nga mëngjesi në darkë më banda? Çfarë modeli duhet të ofrojë një ministër, i cili rri nga mëngjesi në darkë duke bërë afera droge? Çfarë modeli mund t’u ofrojmë ne atyre nëse i mbrojmë dhe u dalim në krah? Shumë mirë mund të themi edhe shprehjen “Nëse mbrojmë një fajtor, ne bëhemi më fajtor se ai”.

Unë e di shumë mirë dhe e them me bindje, se një pjesë juaja janë të ndershëm, të pastër dhe kanë ardhur këtu për të përfaqësuar vërtet qytetarët jashtë. Ju lutem, mos u bëni krahë e atyre, të cilët edhe ju vete i kritikoni në kafene dhe në biseda me njëri-tjetrin dhe nuk i doni! Kështu që

unë ju them që atë gotën plot nuk mund ta shohësh plot me barkun bosh, me këmbët zbathur, me drogën, krimin dhe pasanikët e drogës që enden rreth e rrotull.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Fjalën e ka Adelina për procedurë.

Adelina Rista – Faleminderit, zonja kryetare!

Faktikisht, ne kemi kohë në komision, ka kaluar goxha kohë dhe kemi këtu dy zotërinj të nderuar që kanë ardhur në bazë të kërkesës, që ne si grup deputetësh kemi bërë dhe që presim t'i dëgjojmë. Një pyetje e shtruar nga ju është lënë pezull, pra, do ta vazhdojmë apo jo dëgjesën? Si rregull duhet të hidhet në votim dhe nuk ka diskutim. Ju dhatë mendimin se nuk duhet bërë dëgjesa për arsye se nuk ka ardhur kryetari i AKEP-it, ose t'i bashkojmë të hënën të dyja dëgjesat me të dyja institucionet bashkë.

Dakord, hidheni në votë dhe ne le të vazhdojmë të dëgjojmë, që të kemi mundësi të bëjmë pyetje, të marrim përgjigje dhe të diskutojmë. Unë dua të diskutoj, pasi të dëgjoj në seancë dëgjimore përgjigjet e pyetjeve që kam, por nuk mund ta ndërtoj diskutimin tim pa dëgjuar.

Më duket se e kuptoj hallin tuaj, kolegë të opozitës, që ju mungon mikrofon i parlamentit që e keni bojkotuar dhe përdorni mikrofonin e komisioneve për politikë. Nuk mund ta bëni politikën këtu në komision. Jua kuptoj hallin. A do ta vazhdojmë dëgjesën, zonja kryetare?

Hidheni në votë, do të vazhdojmë apo jo?! Kjo është Rregullorja dhe unë po kërkoj zbatimin e Rregullores. Unë dua të dëgjoj, dua të bëj pyetje, e kam këtë të drejtë ashtu siç e kanë kolegët deputetë, të cilët vijnë dhe të thonë mendimin e tyre dhe ne i dëgjojmë me korrektesë, me seriozitet, nuk i ndërpresim, i respektojmë në fjalën e tyre në maksimum, por, të lutem, më respekt për komisionin, për rendin e ditës dhe për Rregulloren që, në fund të fundit, e kemi miratuar të gjithë bashkë; respekt për këta zotërinj, që kanë dy orë këtu dhe nuk e dinë a do të dëgjohen apo jo.

Këtë po ju kërkoj, zonja kryetare.

Po e riformuloj pyetjen: a do ta bëjmë dëgjesën sot? Nëse jo, hidheni në votë! A do të bëjmë dëgjesë apo do ta shtyjmë për ditën e hënë?

Faleminderit!

Albana Vokshi – Kur të vijë koha, do ta hedh në votë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk më mësoni dot mua si të drejtoj, unë do të zbatoj Rregulloren, se kështu është procedura. Mësojeni që kur merret fjala për procedurë, prevalon!

Ismet Beqiraj – Po propozojnë anëtarët e komisionit, zonjë. Hidhe në votë pastaj vazhdoni, se e keni të gjithë terrenin mediatik për të bërë ligjërata sa të doni.

Albana Vokshi – Ismet, të lutem, pardje e kishte Fideli, sot e ke ti. Do të flasim edhe dy zonjat, pastaj do ta hedh në votë. Mos bëni zhurmë se nuk është mirë.

Fidel Ylli – Pse provokon? Pse ma përmend emrin?

Albana Vokshi – Sepse bëre zhurmë herën e kaluar.

Fidel Ylli – Unë nuk bëj zhurmë asnjëherë, se unë dal me fakte, fotografi dhe argumente dhe ju kam thënë që deri në datë 28 mos u mërzisni, të nderuar kolegë, ne do t'ju durojmë dhe do t'ju respektojmë. Këta do të qetësohen në datën 28. Këta na paskan vënë përgjues se çfarë do të flasim ne me njëri-tjetrin.

Albana Vokshi – Ismet, nuk e merr dot fjalën sa herë të duash ti, se ka rregulla komisioni.

Fidel Ylli – Gjithë kohës provokoni, edhe kur ne nuk flasim, na nxisni ju të flasim.

Albana Vokshi – Nuk e vlerësoj unë se kush të ka sjellë ty; nuk jemi këtu për të bërë biografinë dhe as CV-në tënde.

Tani e ka fjalën zonja Duka dhe ti nuk ia ndërpret dot. E ke marrë fjalën 5 herë sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta hedh, pasi të mbaroj procedurën në respekt të Rregullores.

Më fal, e ka zoti Gurakuqi fjalën.

Të lutem...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër! Lexojeni njëherë Rregulloren, pastaj ta respektojmë atë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka ndërhyrë asnjë!

Mos kini frikë nga fjala!

Komisionin ju e bojkotoni. Nuk na censuron dot. Po flasim për censurën.

Ismet Beqiraj – Ju lutem!

Të marrë fund përdorimi i komisionit që është një komision intelektualësh. Të diskutojmë me logjikë për problemet, për ligjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...për procedurë dhe jo për *show* politik. As PS-ja nuk do ta përdorë komisionin politikisht dhe as një parti tjetër.

Po, zoti Gurakuqi.

Romeo Gurakuqi - Faleminderit, zonja kryetare!

Mjaftoi një ndërhyrje në shkelje të procedurës dhe të ligjit për transmetimet nga AKEP-i për të na kujtuar se në këtë vend Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 10, që përfshin të drejtën e mbajtjes së qëndrimeve dhe opinioneve, si edhe të drejtën për të marrë informacion dhe ide të paanshme, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa vendosur kufizime, mund të shkelet lehtësisht dhe nuk ka një institucion gjyqësor, i cili mund ta zgjidhë këtë çështje.

Mjaftoi vetëm kjo ndërhyrje për të na kujtuar se në këtë vend nuk ka një komision të ankimeve dhe të shtypit, nuk ka një kod të praktikës së shtypit.

Mjaftoi kjo ndërhyrje brutale nga ana e qeverisë për të na kujtuar se pranë Kryeministrit të vendit ekziston zyra e censurës, e cila në prapaskenë merret me organizimin e të gjithë propagandës dhe agjitacionit të qeverisë, që menaxhon daljet publike të suflerëve të qeverisë, kontrollon një sistem të tërë të shkëmbimit të interesave mes pronësisë private të shtypit, medias dhe qeverisë. Të gjitha këto janë indikacione që liria e shtypit në këtë vend ka rënë dhe kjo është arsyeja se në këtë vend nuk mund të bëhen më hetime mbi mënyrën se si shpërndahen fondet e buxhetit të shtetit në territor, për mënyrën se si jepen koncesionet, për mënyrën se si harxhohen fondet e Bashkisë së Tiranës dhe të qeverisë, si edhe një numër fenomenesh të tjera.

Jemi në rrethanat e një shkeljeje masive të të drejtave të njeriut dhe të drejtës së shtypit, të cilën përfaqësuesit e maxhorancës duhet ta vlerësojnë me seriozitetin maksimal, duke qenë se edhe ata pretendojnë se vendi duhet të futet në negociata me BE-në, por për të shkuar deri aty puna fillon para së gjithash nga serioziteti i qeverisë dhe nga respektimi i standardeve të lirisë, duke filluar nga liria e medias dhe nga e drejta e medias për të kontrolluar çdo përfaqësues publik, duke filluar nga Kryeministri i vendit, ministri i Brendshëm dhe të gjitha institucionet.

Albana Vokshi - Faleminderit!

Po, zoti Nasufi.

Fadil Nasufi - Ne ndihemi të privilegjuar si komision, sepse kemi gjithmonë prezent Grupin Parlamentar të PD-së dhe pavarësisht rendit të ditës, këtu artikullohet e gjithë axhenda politike që ka kjo forcë politike; janë në të drejtën e tyre, pa kufizim dhe pa rend dite. Meqenëse këto probleme dolën sot, për çështjet që u mbledhëm sot për AKEP-in dhe për Autoritetin

Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe të Sigurisë Kibernetike, mendoj ta mbyllim mbledhjen. Çfarë ishte për t'u deklaruar u deklarua. Nëse ka probleme gjyqësore, t'i drejtohen gjykatës; nëse ka probleme me shkeljen e ligjit, po kështu t'i drejtohen gjykatës. Mjaft e ndotëm ambientin publik me akuza, artikulime...

Albana Vokshi - Me drogë.

Fadil Nasufi - Drogë është edhe kjo mënyrë të foluri!

Të lutem!

Këtë ke të keqe ti, kur flasim ne, mos ndërhy!

Albana Vokshi – Nuk mund të thuash për kolegët se kanë ndotur ambientin. Ju e ndotët me drogë. Kini pak respekt, etikë. Kemi miratuar Kodin e Etikës.

Fadil Nasufi - Nuk je korrektore, por je drejtuese.

Albana Vokshi - Nuk ju lë të fyeri, siç bëtë herën e kaluar.

Fadil Nasufi – Të lutem!

Kur flisni ju, ne nuk ndërhyjmë!

Mos të merremi me gjëra teknike!

Albana Vokshi – Respekto kolegët dhe Kodin e Etikës!

Fadil Nasufi - Unë jap përgjigjet e mia, edhe personale edhe politike, ashtu si e gjykoj unë, ashtu siç flasin kolegët e mi të opozitës pa kufizim. Ju e keni zakon, sa marrim ne fjalën, ndërhyjni për të na nxjerrë nga ajo...

Albana Vokshi – Fyerje nuk lejojmë.

Fadil Nasufi - Nuk fyejmë. Ne me mënyrën se si flasim, ndotim politikisht, nëse nuk kemi argumente dhe nuk jemi të vetëpërmbytur, dhe të mos dominohemi nga provokimi reciprok i njëri-tjetrit. Ne jemi politikëbërës. Dalim jashtë natyrës sonë pikërisht nga ky lloj emocioni apo provokimi që shkaktohet këtu. Të zbatojmë rregullin numër 1 etik: të mbarojë njëri dhe të fillojë tjetri. Këtu nisi për procedurë. Nëse fillon procedura, zhvillohet kjo mbledhje me këtë rend dite, me mungesën e kryetarit të Autoritetit apo nuk zhvillohet; nëse zhvillohet, e merr fjalën përfaqësuesi i pari, pastaj ne bëjmë pyetjet. Nëse nuk zhvillohet, ikim dhe vijmë ditën e hënë për të zhvilluar mbledhjen. Për mua, e thashë që në fillim, jo për të bërë ironi, po kështu si u diskutua me gjithë problematikën e përditshme që artikulon opozita, përsëri në mbledhjen e ditës së hënë do të thoni: “Censurë, urdhër politik, medie të privuara, medie të ndaluara” e kështu me radhë.

Të lutem, si drejtuese e komisionit, jepi drejtim kësaj mbledhjeje, të mos konsumojmë kohë pa fund, me gjëra që nuk na shkojnë për shtat për atë që përfaqësojmë këtu!

Albana Vokshi- Fadil, kemi vetëm 23 ditë kohë dhe për 23 ditë kohë deri në hapjen e negociatave apo jo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Liria e medias, liria e shtypit, mos censurimi janë kushtet për hapjen e negociatave. Prandaj jemi të gjithë këtu të shqetësuar dhe vetëm ky është halli ynë. Distancohuni nga kjo dhunë, nga censura, nga ministri i Brendshëm, nga krimi, nga droga! Atëherë mundet të kemi një shans të gjithë ne, për t'u dhënë një shans edhe fëmijëve tanë. Prandaj jemi këtu, jemi të shqetësuar dhe do ta bëjmë ditë për ditë këtë punë, rolin e opozitës, për t'ju treguar me fakte se çfarë ju duhet që të korrigjoni.

Po, zonja Duka.

Valentina Duka- Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kam unë fjalën për procedurë!

Të nderuar kolegë, sa herë kam pasur mundësi që nëpërmjet gazetarëve të shtypit botëror të gjigandëve mediatikë CCN apo BBC të dëgjoja lajme që vinin nga vende diktatoriale të botës, ku diktatori urdhëronte të mbyllej *facebook*-u, të mbyllej *twitter*-i apo faqe të tëra që ishin kritikuese ndaj tyre, realisht ndjeja dhimbje dhe më kujtohej koha kur unë jam rritur dhe nuk më krijohet asnjë mundësi të shikoja medien ndërkombëtare.

Më vjen keq nga kolegët që kam karshi, jemi moshatarë, e kanë kaluar këtë kohë dhe diskutojnë realisht në mënyrë të papërgjegjshme. Si mund të mbyllet një portal me titull: “Kryeministri. com”, një portal opozitar satirik, i cili me statuset e tij antikryeministrit, me bëmat që flisnin në mënyrë reale për keqqeverisjen, për papunësinë, për varfërinë, për drogën që filloi të zinte aq vend të rinia, që e ndiqte portalin, të shqiptarët që ndiqnin portalin?! Fakti që ju e mbyllët do të thotë që portali botonte statuse që ju shqetësonin, shqetësonin Kryeministrin dhe qeverinë tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atë ta dëgjojmë nga drejtorët.

Mund të ketë edhe portale të tjera, të cilat mund të jenë opozitare, por mund të mos shqetësojnë kaq shumë Kryeministrin dhe ai nuk jep urdhër për t'i mbyllur, por mbylli këtë portal.

Nëse ne si Komision për Medien do të lejojmë që ky portal të mbyllet, unë kam bindjen se me radhë gjatë javës do të shikojmë që dhjetëra portale të tjera do të mbyllen. Prandaj urgjentisht drejtori i AKEP-it, drejtori i Agjencisë tjetër, ditën e hënë të jenë këtu dhe të japin llogari përpara deputeteve: përse u mbyll ky portal?

Urgjentisht ne t'u kërkojmë atyre që ky të rihapet, sepse është një portal shumë i rëndësishëm opozitar dhe duke e rihapur, i rikujtojmë edhe një herë Kryeministrit shqiptar të mos ketë të drejtë të vërë dorë në mbylljen e portaleve të tjera.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Unë do të ngre edhe një pyetje për ju dhe për autoritetin, që do ta ftojme të hënë. Pse nuk mbyllet portali “Shqipëria që duam”, sepse është i paligjshëm? Cila është arsyeja që ju nuk e mbyllni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me fonde publike. Është i paligjshëm, sepse rrëzon ligjet që keni miratuar. Portali “Shqipëria që duam” është i paligjshëm, shkel çdo procedurë ligjore.

Ismet Beqiraj – Albana, ju lutem!

Albana Vokshi – Për mendimin tim, duhet mbyllur.

Ismet Beqiraj – A e kupton çfarë helmi mediatik hedh?

Albana Vokshi – Nuk vlen më procedura.

Ismet Beqiraj – Drejtoju gjykatës ...

Albana Vokshi – Ty nuk të vlejné më ministrat.

Ismet Beqiraj – Je kryetare e Komisionit të Medies.

Albana Vokshi - Pse të duhen ministrat? Për të qëndruar aty në karrige?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kam pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk po të kërkoj ty përgjigje. Portali është i paligjshëm dhe duhet mbyllur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk të kërkoja përgjigje, Ismet. Mos u përgjigj sot për çdo ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është pyetje për të, kështu që mos u

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E thashë për herën tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk qenke mirë sot ti!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vazhdo, të lutem!

Ismet Beqiraj – Ti nuk pranon të të kthej përgjigje, ndërsa për pyetjet që do...

Bujar Çela – Duke falënderuar shokun Ismet, për qetësinë që vendosi tani, komisioni ynë është kthyer vet në një portal të paligjshëm. Portali më i paligjshëm është ky komision. Ne nuk po u shpërndajmë asgjë edukative, asgjë ligjore, që u shërben atyre që protestojnë dhe shumicës së popullit shqiptar, të cilët presin hapjen e negociatave më 28 qershor.

Ju vetë po e thoni me fjalët tuaja të ripërsëritura, që janë edhe 23 ditë. Ëndrra juaj është të luftoni kundër ëndrrës ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shoku Ismet, prit një herë, se ti kalon nga Lushnja për të shkuar në Ballsh.

Ju po bini ndesh me të gjithë ëndrrën e shqiptarëve, që ka nisur në vitin 1991, për ta parë Shqipërinë si e gjithë Europa. Ju po e pengoni. Atëherë ishit krah të gjithë së bashku, sepse, siç thotë edhe shoku Luan, jemi brezi që kemi luftuar në sheshe për ta parë Shqipërinë, siç po na jepet mundësia sot.

Albana Vokshi – Të mbushur me krim dhe drogë.

Bujar Çela – Edhe po të jetë ajo, as droga, as të gjitha veset që përjeton kjo histori nuk kanë një datë fikse se kur kanë ardhur. Detyra jonë është të luftojmë për t'i larguar nga shoqëria jonë.

Albana Vokshi – Pikërisht.

Bujar Çela – Arsyeja që kjo ka ngelur pakicë është shumë e thjeshtë, sepse po vazhdon luftën kundër shumicës, popullit, i cili do institucionet ndërkombëtare më present, që ne na drejtojnë jo në rrugë të gabuar, por në rrugë që ata i kanë vuajtur.

Kur është miratuar ky ligj me transparencë në mandatin e shkuar, rreth muajve janar-maj 2017, ne nuk mendonim se do të qeverisnim. Atë e përcaktoi populli. Ne kishim një tmerr të madh, si nga çadra e republikës së re, edhe nga forca e parë e pavarur, por qytetarët na thanë “Drejtoni

ju, sepse këta nuk vijnë për ne! Këta gjithmonë do të vijnë, siç kanë ardhur, për të goditur gazetarët, për të goditur ligjet, për të goditur të gjitha institucionet shtetërore”.

Ju lutem, të mos bëjmë *show* me njëri-tjetrin!

Unë i respektoj të gjithë anëtarët e komisionit parlamentar të opozitës, që janë prezent, por a nuk keni mikrofon ju të tjerët? Na lini të punojmë!

Keni bërë një ndarje, mbaron fjalën njëri, ikën tjetri. Të gjithë keni të njëjtën gjë. Mezi po prisni që bota t’u thotë “jo” shqiptarëve, “nuk ju duam”. Doni apo nuk doni ju, bota e ka hapur këtë derë dhe nuk e ka hapur në interesin tonë, të njërit apo tjetrit, por i duhemi kësaj Europe. Na duan, sepse ju duhemi, jo sepse po vdesin për ne.

Ju lutem, mos na bëni të tregohemi si dele të zeza. Nuk po ju them “mos flisni në këtë moment”. Bëjeni për hatrin tonë, bëjeni për hatrin e fëmijëve tanë dhe për hatër të kësaj rruge që ka nisur dhe është rrugë pa kthim! Mos gëzoni, sepse nuk do të keni shanse të duartrokisni, sepse do t’ju zënë fëmijët tuaj me gurë për qëndrimin që po mbani! Do t’ju dënojë historia.

Albana Vokshi – Më fal, por se kë do të dënojë historia, është për t’u parë.

Bujar, se kë do të dënojë historia, është për t’u parë. Do të dënojë Edi Ramën, që e çoi në këtë derexhe Shqipërinë dhe shoqërinë shqiptare ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vilma, ju lutem!

Të kam thënë, je nga Vlora dhe ty nuk të bën nder fare ...

Milva, për procedurë!

Milva Ekonomi – Kolegë, a mund të keni vëmendje një minutë?

Besoj se duhet ta mbyllim punën në këtë komision sot. Ne diskutuam të gjithë dhe thamë se kemi më shumë nevojë të kemi përfaqësues për ta kuptuar këtë çështje. Ramë dakord që kjo çështje të shtyhet të hënën, të thirren të dyja palët dhe të na bëjnë një prezantim se si ka qenë kjo situatë. Ne besojmë se është e paligjshme, ju besoni se është e ligjshme. Kemi nevojë të ballafaqohemi me këtë fakt. Ta mbyllim seancën e sotme dhe ta rihapim të hënën, në orën 11:00, siç e kemi zakon. Jeni gati për ta votuar këtë propozim, apo jo?

Albana Vokshi – Jeni dakord që të dy autoritetet të jenë ditën e hënë? Nuk ka nevojë të bëjmë më kërkesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E caktojmë ne radhën!

Jeni dakord për të hënë, në orën 11:00?

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar, po e mbyll. Dëgjo!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me gjithë respektin për ju, njoftoni të vijë zoti Zela të hënë, në orën 11:00.

MBYLLET MBLEDHJA